

## RREGULLAT E FONDIT WVP TOP INVEST

Rregullat e Fondit rregullojnë kushtet e veprimtarisë së Fondit të Investimit WVP Top Invest (në vijim referuar si “Fondi”), themeluar nga WVP Fund Management Tirana sh.a - Shoqëri Administruese e Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive, si dhe marrëdhëniet ligjore ndërmjet WVP Fund Management Tirana sh.a (në vijim referuar si “Shoqëri Administruese”), si dhe mbajtësve të kuotave (në vijim referuar si “Investitorët”).

**Shënim:** Rregullat e fondit nuk përmbajnë detyrimisht të gjithë informacionin dhe të dhënat e paraqitura në Prospektin e Fondit. Investitorët këshillohen të lexojnë të gjithë përmbajtjen e prospektit.

### Neni 1

#### Krijimi dhe Kohëzgjatja e Fondit

- 1.1 Fondi është krijuar për një afat të pacaktuar dhe ka filluar aktivitetin me datë 29.03.2018
- 1.2 Prospekti i Fondit është miratuar nga Këshilli i Administrimit të Shoqërisë Administruese, si dhe miratuar nga AMF me vendim nr. 14, datë 31 Janar 2018.

### Neni 2

#### Objekti i veprimtarisë së Fondit

Objekti i veprimtarisë së Fondit është grumbullimi i aseteve monetare ose të ngjashme nëpërmjet ofertës publike të kuotave në Fond, të cilat investohen sipas parimit të diversifikimit të rreziqeve në përputhje me prospektin. Investitorët kanë të drejtë të marrin pjesë proporcionalisht në fitimet e fondit, si dhe të kërkojnë në çdo kohë shlyerjen e kuotave të tyre, sipas dispozitave të Ligjit nr. 56/2020 “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive” (në vijim referuar si “Ligji”) si dhe Prospektit.

### Neni 3

#### Monedha e Fondit

Monedha bazë e Fondit është LEKË.

### Neni 4

#### Pjesëmarrja në Fond

- 4.1 Çdo person mund të blejë kuota në Fond, duke hyrë në një marrëdhënie ligjore me Shoqërinë Administruese.
- 4.2 Shoqëria Administruese llogarit dhe publikon çdo ditë vlerën e kuotës. Llogaritja e vlerës neto të aseteve dhe çmimit të kuotës i nënshtrohet kontrollit dhe verifikimit nga Depozitari, i cili është përgjegjës për saktësinë e llogaritjes.
- 4.3 Çdo investitor nënshkruan formularin standart të blerjes së kuotave, duke konfirmuar se është njohur dhe ka rënë dakord me kushtet e përcaktuara në Prospekt dhe Rregullat e Fondit.

## Neni 5

### Objektivi i Investimit

Objektivi i Investimit të Fondit është që t'i sigurojë Investitorit një kthim nga investimi nëpërmjet një menaxhimi të kujdesshëm të portofolit, duke ruajtur në të njëjtën kohë nivelin e nevojshëm të kapitalit dhe të likuiditetit, në përputhje me politikën e investimit të përcaktuar në Prospekt.

## Neni 6

### Të drejtat dhe përgjegjësitë e Investitorëve në Fond

Investitorët në Fond kanë të drejtat e mëposhtme:

- a. Të kenë pronësinë e kuotave dhe të pajisen me çertifikatën e pronësisë;
- b. Të marrin pjesë në fitimet e Fondit, proporcionalisht me pjesëmarrjen në të;
- c. Të informohen periodikisht (raporte vjetore, etj);
- d. Të kërkojnë shitjen e pjesëshme apo të plotë të kuotave në çdo kohë;
- e. Të transferojnë pronësinë e kuotave në Fond ;
- f. Të drejtën për t'i këmbyer kuotat;
- g. Në rast falimenti të Shoqërisë Administruese dhe/ose Depozitarit, asetet e tyre të jenë objekt i së drejtës së veçimit
- h. Investitorët në Fond janë përgjegjës për detyrimet e Fondit deri në shumën e pjesëmarrjes së tyre në Fond.

## Neni 7

### Shlyerja e Kuotave

7.1 Investitorët kanë të drejtë të kërkojnë në çdo kohë shlyerjen e kuotave të tyre.

7.2 Investitorët plotësojnë një kërkesë për shlyerje të kuotave në Fond.

7.3 Shlyerja e kuotave në Fond bëhet nga Shoqëria Administruese, jo më vonë se 7 ditë kalendarike nga dita e mbërritjes së kërkesës.

## Neni 8

### Të drejtat dhe detyrimet e Shoqërisë Administruese

Shoqëria Administruese gjatë administrimit të fondit ka detyrimet e mëposhtme :

- a. Të administrojë Fondin në përputhje me objektivat e investimit të parashikuara në Prospekt;
- b. Të blejë asetet, në emër dhe për llogari të Fondit, duke i depozituar ato te një Depozitar i vetëm;
- c. Të organizojë shitjen e kuotave të Fondit sipas procedurave të përcaktuara në Ligj dhe Prospekt;
- d. Të shlyejë në kohën e duhur dhe në mënyrë të vazhdueshme të gjitha detyrimet monetare;
- e. Të informojë periodikisht investitorët, sipas parashikimeve në Prospekt;
- f. Të garantojë ruajtjen e fshehtësisë së të dhënave nën administrim.

## **Neni 9**

### **Tarifat**

9.1 Shoqëria Administruese do të aplikojë tarifën e hyrjes nga 5% - 1% në varësi të shumës së investimit, e cila do t'i ngarkohet investitorit në momentin e blerjes së kuotave dhe e njëjta vlerë i zbritet nga shuma e investimit të parë.

9.2 Shoqëria Administruese nuk do të aplikojë tarifë për shlyerjen e kuotave

9.3 Tarifat/kostot që do të paguhet nga asetet e fondit janë: tarfa e administrimit, e cila do të jetë 2% në vit e vlerës neto të asetëve të Fondit; tarifat dhe kostot e depozitarit, komisionet ose shpërblimet për shitblerjen e Aseteve, kostot për auditimin vjetor, tarifat rregullatore, kostot e komunikimit të ndryshimeve në prospekt, kostot e e përgatitjes, të shtypjes dhe tarifat postare për raportet vjetore për mbajtësit e kuotave

9.4 Çdo ndryshim i tarifave që do të aplikohet nga Shoqëria Administruese, do t'u njoftohet investitorëve sipas procedurave të përcaktuara në Ligj dhe prospektin e Fondit.

## **Neni 10**

### **Ruajtja e Konfidencialitetit**

10.1 Shoqëria Administruese dhe çdo punonjës i saj trajton informacionin e klientit si shumë konfidencial.

10.2 Të gjithë personat, qofshin punonjës të Shoqërisë Administruese, Depozitarit, apo palëve të lidhura me to, janë përgjegjës për pasojat që rrjedhin direkt nga veprimet e tyre dhe që kanë të bëjnë me keqpërdorimin e informacionit konfidencial.

## **Neni 11**

### **Viti Financiar**

11.1 Viti financiar i Fondit konsiderohet viti kalendarik, Janar – Dhjetor.

11.2 Shoqëria Administruese përgatit pasqyrat financiare dhe raportet e tjera financiare në përputhje me legjislacionin dhe standartet e pranuar të SNRF.

## **Neni 12**

### **Auditimi**

12.1 Shoqëria Administruese bën të mundur që pasqyrat financiare të auditohen nga ekspertët kontabël të autorizuar, të miratuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.

12.2 Audituesi i jashtëm i Fondit është Grant Thornton sh.p.k.

## **Neni 13**

### **Depozitari**

13.1 Banka Depozitare e Fondit do të jetë First Investment Bank Albania, me seli në adresën Bulevardi "Deshmoret e Kombit", Twin Towers, Kulla 2, Kati 14 Tirane.

13.2 Pjesë përbërëse e rregullave të fondit është Deklarata e Kujdestarisë e Depozitarit.

#### **Neni 14**

##### **Miratimi dhe ndryshimi i Rregullave të Fondit**

14.1 Rregullat e Fondit miratohen nga Këshilli i Administrimit të Shoqërisë Administruese.

14.2 Ndryshimet dhe shtesat në rregullat e Fondit, do të miratohen nga Këshilli i Administrimit si dhe do të marrin miratimin e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare në përputhje me dispozitat e Ligjit.

#### **Neni 15**

##### **Dispozita të fundit**

15.1 Çdo mosmarrëveshje që mund të lindë nga zbatimi apo interpretimi i këtyre rregullave, do të zgjidhet bazuar në legjislacionin shqiptar, ku kompetente për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve do të jetë Gjykata e Shkallës së Parë, Tiranë.

15.2 Rregullat e Fondit hyjnë në fuqi në datën e miratimit nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.